



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN
ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË
TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR.**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Mbi zbatimin e vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike", Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", i ndryshuar, Udhëzimit Nr. 5, dt. 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, Vëndimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2026 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës të gjykojë konform akteve ligjore dhe,

TË VENDOS:

- I. Miratimin e kriterëve mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind, si më poshtë:
 - a) Familjet në nevojë që për zgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar, për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - b) Përfitues do të jenë aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.

- c) Familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar, me prioritet si: familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, familje me 1 (një) anëtar dhe gratë kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim., familje pa të ardhura, të moshuar të vetmua, rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët jashtë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe me fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
- a) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës përpunojnë listën e përfituesve dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
 - b) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës dhe Njësitë Administrative dërgojnë projektvendimet çdo muaj pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Durrës, e cila harton listën e përfituesve të mundshëm.
 - c) Njësitë administrative propozojnë fondin e kushtëzuar për çdo familje, referuar udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përlllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar.
 - d) Njësitë administrative konfirmojnë shkresërisht çdo muaj, pas zbardhjes së vendimit për ndihmën ekonomike, listën e personave që do të vazhdojnë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor mbi bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind.
 - e) Drejtoria e Shërbimit Social, harton projektvendimin për familjet në nevojë, që do të trajtohen në bazë bazë të vlerësimit social-ekonomik dhe propozimeve të bëra nga njësitë administrative dhe lagjet, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.
3. Të miratojë dokumentacionin që duhet të plotësojë Administratori Social mbi aplikimin e përfitimit nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë;
- a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti;
 - b) Çertifikatën familjare që lidhet me regjistrin e familjes, për të gjithë ata persona që janë pjesë e të njëjtës gjendje familjare;
 - c) Dokumenta të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare;
 - d) Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesit shoqëror, për rastet e parashikuara;
 - e) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara;
 - f) Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqitet për të përfituar ndihmën ekonomike janë në proces zgjidhjeje martesore;

- g) Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar;
- h) Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentacionet e tjera;
- i) Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;
- j) Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues.

4. Dokumentacioni shkresor nga njësitë administrative përmban:

- a) Listën përmbledhëse emërore të përfituesve të mundshëm, sipas shtojcës nr. 4, të VKM-së 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar;
- b) Tabela përmbledhëse mbi numrin e familjeve dhe fondin e parashikuar.

5. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike", i ndryshuar.

6. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimit Social për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Drejtor

Alneida Rroshi



DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE


Drejtor

Diola Xhango



KRYETAR

Emirlana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAAFTËSISË

Nr. _____ prot.

Durrës, më _____.2026

RELACION

PËR

MIRATIMIN E KRITEREVE PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR DHE FONDIT TË BUXHETIT VENDOR, MBI PROGRAMIN E BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND PËR VITIN 2026

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreut IV, pika 1, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, të Udhëzimeve të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr.3,4,5 datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e Fondit të Kushtëzuar për Bllok Ndhmën Ekonomike deri në 6%”, të ndryshuar, Vëndimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2026 “Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Drejtorla e Shërbimit Social paraqet këtë relacion për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor.

Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe i Paaftësisë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, ka si objekt të aktivitetit të tij;

1. Të kontrollojë dhe verifikojë dokumentacionin ligjor për familjet që hyjnë në skemën e ndihmës ekonomike, paaftësisë dhe invalidëve të punës.
2. Të kontrollojë gjendjen – social ekonomike të familjeve pretenduese në skemën e ndihmës ekonomike së bashku me administratorët shoqëror për raste të vecanta.
3. Të Përgatisë evidencat dhe statistikën mujore sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
4. Të Përgatisë Projekt – vendimin sipas kërkesave të sjella nga administratorët shoqërore.

Për sa më sipër është e domosdoshme që çdo fillim vitit të hartohen kriteret përkatëse lidhur me përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe fondit të buxhetit vendor, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind për vitin 2026, kjo mbështetur në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, në të cilin thuhet:

Këshilli bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Referuar mbështetjes ligjore sa më sipër cituar Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe i Paaftësisë pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale ka hartuar kriteret e poshtë shënuara për tu miratuar nga Këshilli Bashkiak në mbledhjes e radhës., si më poshtë vijon:

1. Miratimin e kriterëve mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
 - a) Familjet në nevojë që përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nëpërmjet Regjistrat Elektronik Kombëtar, për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - b) Përfitues do të jenë aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - c) Familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar, me prioritet si: familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, familje me 1 (një) anëtar dhe gratë kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim., familje pa të ardhura, të moshuar të vetmua, rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët jasnë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe me fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
 - a) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës përpunojnë listën e përfituesve dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
 - b) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës dhe Njësitë Administrative dërgojnë projektvendimet çdo muaj pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Durrës, e cila harton listën e përfituesve të mundshëm.
 - c) Njësitë administrative propozojnë fondin e kushtëzuar për çdo familje, referuar udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar,
 - d) Njësitë administrative konfirmojnë shkresërisht çdo muaj, pas zbardhjes së vendimit për ndihmën ekonomike, listën e personave që do të vazhdojnë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor mbi bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind.
 - e) Drejtoria e Shërbimit Social, harton projektvendimin për familjet në nevojë, që do të trajtohen në bazë bazë të vlerësimit social-ekonomik dhe propozimeve të bëra nga njësitë administrative dhe lagjet, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 për qind.
3. Të miratojë dokumentacionin që duhet të plotësojë Administratori Social mbi aplikimin e përfitimit nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, si më poshtë:
 - a) **Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti;**
 - b) Çertifikatën familjare që lidhet me regjistrin e familjes, për të gjithë ata persona që janë pjesë e të njëjtës gjendje familjare;
 - c) Dokumenta të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare;
 - d) Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesit shoqëror, për rastet e parashikuara;

- e) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara;
 - f) Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqitet për të përfituar ndihmën ekonomike janë në proces zgjidhjeje martesore;
 - g) Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 "Për statusin e jetimit", të ndryshuar;
 - h) Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentacioniet e tjera;
 - i) Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;
 - j) Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues.
4. Dokumentacioni shkresor nga njësitë administrative përmban:
- a) Listën përmbledhëse emërore të përfituesve të mundshëm, sipas shtojcës nr. 4, të VKM-së 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar;
 - b) Tabela përmbledhëse mbi numrin e familjeve dhe fondin e parashikuar.
5. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 "Për përllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike", i ndryshuar.
6. Familjet e përzgjedhura do të përfitojnë ndihmën ekonomike nga fondi i kushtëzuar i programit të bllok-ndihmës deri në 6 për qind dhe nga fondi i vënë në dispozicion nga Bashkia Durrës , fond i miratur në buxhetin e vitit 2026..

Duke ju falenderuar ,

DREJTOR

Diola Xhango

